VENDIM
Nr. 325, datë 31.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE NË TURIZËM

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 1.3.2023)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin, si më poshtë vijon:

- Sekretari i Përgjithshëm, kryetar;
- *Drejtori i Zhvillimit të Programeve të Turizmit*, anëtar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, anëtar;
- Drejtori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, anëtar;
- *Drejtori i Projekteve Zhvillimore të Turizmit*, anëtar.

2. Përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, përfaqësues të shoqatave në sektorin e turizmit, si më poshtë vijon:

- Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA);
- Shoqata *"Albanian Incoming Travel Association"*.

2. Vendimi nr. 129, datë 22.2.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama